

## Formular për SYLLABUS të Lëndës: Organizatat Nderkombetare

Të dhëna bazike të lëndës	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti Juridik</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Organizatat Nderkombetare</b>
<b>Niveli:</b>	<b>MA</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I –rë</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2L+2U</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6 ECTS</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>16:00-18:00, E enjte, Fakulteti Juridik, Salla D 2</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Dr. Remzije Istrefi</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>Remzije.istrefi@uni-pr.edu</b>
Përshkrimi i lëndës	
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Lënda Organizatat Ndërkombëtare është një lende e specializuar mbi organizatat ndërkombëtare. Në pjesën e parë të lëndës do të shqyrtohet evolucioni historik, debati teorik, dhe bazat ligjore dhe politike të institucioneve dhe regjimeve ndërkombëtare, si dhe aktivitetet specifike të organizatave ndërkombëtare në fushën e sigurisë ndërkombëtare, në ekonominë politike ndërkombëtare, si dhe zhvillimin e shoqërisë civile trans-nacionale. Pjesa e dytë e lëndës do të diskutoj mbi debatin aktual për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kapacitetit ligjor dhe personalitetit juridik. Pjesa e fundit e lëndës do të përqendrohet në debatin bashkëkohor mes qasjes racionaliste dhe konstruktiviste për rolin e organizatave ndërkombëtare në politikën botërore. Këtu sigurisht do të përqendrohem në diskutimin e rolit të organizatave ndërkombëtare në reagimin ndaj problemeve globale dhe specifike si mbrojtja e të drejtave të njeriut, llogaridhenja e organizatave ndërkombëtare. Në veçanti këtu diskutimi do të përqendrohet në rolin e organizatave ndërkombëtare në Kosovë para dhe pas konfliktit.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qe të shqyrtoje rolin e organizatave ndërkombëtare në arenën globale;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• qe të diskutoje ngjarjet kryesore që aktuale në lidhje me organizatat ndërkombëtare dhe rolin e tyre në arenën globale;</li> <li>• qe të diskutoje parimet kryesore teorike dhe konceptet e përdorura për të studiuar organizatat ndërkombëtare;</li> <li>• qe studentet të kuptojnë arsye të ndryshme pse organizatat ndërkombëtare janë formuar dhe shuhen ose ballafaqohen me sfida të vazhdueshme;</li> <li>• qe të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik tek studentet</li> </ul>

	duke analizuar problemet globale nga kënde të ndryshme dhe perspektivat rreth organizatave nderkombetare		
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Pas përfundimit të kësaj lende studentet duhet të jetë në gjendje të:</p> <p>Kuptojnë qasjet ekzistuese akademike dhe kundërthenese ne lidhje me organizatat ndërkombëtare;</p> <p>Studentet do të jene ne gjendje te shqyrtojnë dimensionet politike, ekonomike dhe sociale ekzistuese ne lidhje me organizatat ndërkombëtare.</p>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15/week	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15/week	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsulent	2	2	4
Ushtrime në teren	5	1	5
Kollokfiime,seminare	4	4	16
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	2	3	6
<b>Totali</b>			<b>126</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjerate interaktive e kombinuar me stil te punës praktike te bazuar në studimet e rasteve, tekste origjinale ligjore dhe politike, elemente te seminarit, folës të ftuar, dhe dokumente kërkimore praktike, provimet afatmesme dhe përfundimtare.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>			

	<p>Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive ne klase 25%</p> <p>Testi I mesëm 25%</p> <p>Provimi përfundimtare 50% e notes</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<p><b>Dr. Remzije Istrefi, Organizatat Nderkomebtare, Ligjeratat te autorizuar</b></p> <p><b>Dr. Zejnullah Gruda E Drejta Ndërkombëtare Publike si dhe</b> tekste dhe/apo librat e leximit ne gjuhen Shqipe dhe Angleze do të sigurohen nga ana e ligjëruesit:</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>Clive Archer., International Organizations (New York and London: Routeledge, 1992).</p> <p>Werner J. Feld and Robert S. Jordan with Leon Hurëitz ., International Organizations ( New York and London : Preager, 1988).</p> <p>A. LeRoy Bennet., International Organizations ( New Jersey: Prentice Hall, 1995).</p> <p>“Libri i Bardhë për Përgatitjen e Vendeve të Asociuara të Europës Qendrore dhe Lindore për Integrimin në Tregun e Brendshëm të Bashkimit Evropian” Në dispozicion tek: <a href="http://mie.gov.al/skedaret/1158676591-Libri%20i%20Bardhe.pdf">http://mie.gov.al/skedaret/1158676591-Libri%20i%20Bardhe.pdf</a></p> <p>“15 Pyetje për Bashkimin Evropian” Në dispozicion tek: <a href="http://mie.gov.al/skedaret/1199717851-15_pyetje_be.pdf">http://mie.gov.al/skedaret/1199717851-15_pyetje_be.pdf</a></p> <p>“Glosar për Integrimin European, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian” Në dispozicion tek: <a href="http://mie.gov.al/skedaret/glosar_per_integrimin_european.pdf">http://mie.gov.al/skedaret/glosar_per_integrimin_european.pdf</a></p>
<b>Plani i dizajnuar i mësimi:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	<p><b>Hyrje në përmbajtjen e synimeve dhe kërkesave të lendes</b></p> <p>Historia dhe zhvillimi bashkëkohore i Organizatave Ndërkombëtare</p> <p>Evolucioni i Organizatave Ndërkombëtare</p> <p>Çfarë është një organizatë ndërkombëtare</p>
<i>Java e dytë:</i>	<b>Organizatat Jo-Qeveritare dhe Organizatat nder-</b>

	<p><b>qeveritare</b>, aktoret transnacional dhe rrjetat e politikave</p> <p>Teoritë e Institucioneve Ndërkombëtare , (Realizmi, Liberalizmi, Konstruktivismi,)</p> <p>Diskutim mbi zhvillimin historik të organizatave ndërkombëtare.</p>
<i>Java e tretë:</i>	<p><b>Organizatat ndërkombëtare si burokraci: Administrata dhe Menaxhmenti</b></p> <p>Hyrje: Kombet e Bashkuara (OKB)</p> <p>Struktura dhe funksionet</p>
<i>Java e katërt:</i>	<p><b>Zhvillimi i OKB-së para, gjatë dhe pas viteve të Luftës së Ftohtë</b></p> <p>Performanca e OKB-së dhe Reforma në OKB</p>
<i>Java e pestë:</i>	<p><b>Organizatat ndërkombëtare, ekonomia politike ndërkombëtare dhe zhvillimi i saj</b></p>
<i>Java e gjashtë:</i>	<p><b>Regjionalizmi dhe Integrimi Regjional</b></p>
<i>Java e shtatë:</i>	<p><b>Mbi-kombëtarizmi/mbi-sovraniteti</b></p> <p>Hyrje: Bashkimi Evropian (BE).</p> <p>Dilemat kryesore teorike, Sovranitet apo mbi-kombëtarizim/mbi-sovranitet</p>
<i>Java e tetë:</i>	<p><b>Testi afat-mesëm</b></p>
<i>Java e nëntë:</i>	<p><b>Organizatat Ndërkombëtare në Politikën Botërore</b></p> <p>Kombet e Bashkuara, Korniza Ligjore dhe Proceset Politike brenda sistemit të OKB-së</p> <p>Bashkimi Evropian, Korniza Ligjore dhe proceset politike brenda sistemit të BE-së .</p>
<i>Java e dhjetë:</i>	<p><b>Politikat Transnacionale dhe Qeverisja Globale, aktoret jo-shtetëror</b></p> <p>Qeverisja Globale</p>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<p><b>Mirëqenia dhe Zhvillimi Global</b></p> <p>Roli i Organizatave Ndërkombëtare</p>
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<p><b>Organizatat ndërkombëtare dhe të Drejtat e Njeriut</b></p> <p>Gjykatat Ndërkombëtare (ICTY, ICTR, ICC)</p>
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<p><b>Roli i Organizatave Ndërkombëtare në Kosovë para vitit 1999 (UN /MIK, BE-së / EULEX-it, OSBE-së)</b></p>
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	<p><b>Roli i Organizatave Ndërkombëtare në Kosovë para vitit 1999 (UN /MIK, BE-së / EULEX-it, OSBE-së)</b></p>
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	<p><b>Provimi përfundimtar</b></p>

### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

*Mësimi dhe procesi i nxënjes së studentëve si dhe realizimi i objektivave të lëndës do përcillet nga profesori i lëndës përmes vlerësimit vazdhues të progresit të studentëve në një kohë dhe në një mënyrë që siguron informacion të mjaftueshëm ;*

*Studentët janë të inkurajuar fuqimisht për të bërë pyetje, komente dhe të marrin pjesë aktive në diskutime në klasë;*

*Sjellja e duhur akademike si dhe vijimi i rregullt im mesimit është një domosdoshmëri;*

*Kopjimi i punës së të tjerëve, përdorimi i materialeve të pamiratuara gjatë provimeve , ose duke marrë kredi për punën që ju nuk bëni aktualisht është konsideruar mashtrim dhe nuk do të tolerohet;*

*- përdorimi i Lap-top lejohet vetëm kur miratohet nga profesori .*

*- përdorimi i telefonit celular është i ndaluar;*

*Te gjitha rregullat e parapara në Kodin Akademik të Universiteti do të jenë të aplikuara në këto lende .*